



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**  
**KRYETARI**

Nr. 1527/3 prot.

Vau Dejes, më 04.04.2025

Lënda: Kërkese për mbledhje jashtë radhës

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

Për shkak të nevojës urgjente për miratimin e “Deklaratës për bashkëfinancim, e miratuar parimisht me vendim të Këshillit Bashkiak” (e shprehur në përqindje dhe lekë) për projektin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa-favorizuara”, pika a. “Përmirësimi i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi, si dhe në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime, etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme” për zonën e Mjedës, kërkoj që të mblihet Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, jashtë radhës, mbështetur në Nenin 53, pika 3, germa a e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Këshilli të mblihet për miratimin e “Deklaratës për bashkëfinancim” me vlerën 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë lekë) ose 20% të kontributit të bashkisë për projektin e programit “Përmirësimi i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi, si dhe në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime, etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”, për zonën e Mjedës. Ky vendim është i nevojshëm për plotësimin e dokumentacionit për aplikim në thirrjen e hapur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, dërguar me shkresën nr. Prot. 15900, datë 18.12.2024, me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**KRYETARI**

**Kristian Shkrefi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Nr 1528 Prot

Vau Dejës me 04.04.2025

**Lënda:**Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

**Drejtuar:**Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53 pika 3, germa a, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se zhvillohet mbledhje jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës ditën e Marte me datë 08.04.2025 ora 14.00. Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Rendi i ditës:

1.Projekt vendim për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim për projektin me Ministrinë e Ekonomisë,Kultures dhe Inovacionit.

Komisioni i Këshillit do të mbledhet me datë 07.04.2025 ora 9.00 Nj.A Bushat.

Komisioni i financë buxhetit,pasurive bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, mbikqyrjes financiare.

Zv/Kryetari

Erano Prenga

